

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Për draftin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026 - 2030:

(Përcaktoni/shkruani komentet e kujt po kërkon (veçanërisht), p.sh. komente (të përgjithshme) publike, nga komuniteti ekspert në fushën përkatëse, nga organet përfaqësuese të komunitetit të biznesit, nga organizatat joqeveritare dhe individët me përvojë në fushën përkatëse, etj.)

Projektvendimi është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS me kontributin e grupit ndërinstitucional të punës të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 577, datë 08.11.2024, "Për ngritjen e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Planit të Veprimit për Garancinë e Fëmijëve 2026-2030". Grupi i punës përbëhet nga përfaqësues të MSHMS, MAS, MEI, MF, MB, MSHPV, MSHRF, ASHMDF, SHSSH dhe ISHP.

Qëllimi i këtij projektakti është parandalimi i përjashtimit social dhe sigurimi i aksesit efektiv e gjithëpërfshirës në shërbime themelore për fëmijët në nevojë. Sipas përkufizimit që përdor Bashkimi Evropian, kategoria "fëmijë në nevojë", u referohet të miturve nën 18 vjeç në rrezik varfërie ose përjashtimi social, të cilët duhet të përfitojnë akses falas dhe efektiv në edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, arsimin e detyrueshëm dhe atë të mesëm (përfshirë aktivitetet jashtëshkollore), garantimin e të paktën një vakti ushqimor të shëndetshëm çdo ditë shkollore, kujdesin shëndetësor; si dhe akses efektiv në ushqyerjen e shëndetshme dhe strehim të përshtatshëm. Në përputhje me objektivat dhe standardet e Garancisë Evropiane për Fëmijët, plani ndërthur politika dhe masa të integruara ndërsektoriale në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale dhe strehim, në nivel kombëtar, vendor e komunitar, duke synuar një qasje gjithëpërfshirëse e të koordinuar.

Ky projektakt i drejtohet grupeve të interesit të cilat ndikohen nga ky projektakt dhe që kanë vendimmarrje në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi për Planin Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026 – 2030, është zhvilluar në dy faza: në fazën e parë të shtrirë në periudhën Prill-Korrik 2025, u identifikuan nevojat dhe prioritetet e më pas gjatë periudhës Shtator-Nëntor janë zhvilluar takime të ngushta teknike tematike me stafet e ministrive, institucionet arsimore, bashkitë, ofruesit e shërbimeve të shëndetit parësor, fëmijët dhe prindërit, me shoqërinë civile, ministrinë e linjës dhe agjencitë përkatëse dhe me anëtarët e Grupit të Teknik Ndërinstitucional të Punës.

Si të përgjigjeni:

Shkruani si mund të përgjigjen palët e interesuara/publiku në konsultime, p.sh. Me email; Me postë në; Duke plotësuar formularin në internet në RENJKP (siguroni linket e drejtpërdrejta).

Janë zhvilluar 5 (pesë) takime konsultuese, përkatësisht me organizatat e shoqërisë civile "NISMA ARSIS", "MEDPAK", "World Vision", "Alo 116", "I Sigurt.al" dhe "CRCA"; partnerët ndërkombëtarë "UNICEF", Save the Children, Delegacionin Evropian. Po ashtu, takime konsultuese janë zhvilluar

edhe me INSTAT, bashkitë, Këshillin Kombëtar të Fëmijëve, ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë.

Projektakti është konsultuar edhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore të datës 09/12/2025.

Kontakti:

Duhet të jepen të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe /ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet.

Znj. Erviola Nelaj (Poro), Përgjegjës Sektori i Zhvillimit të Ndhmës Ekonomike

Erviola.nelaj@shendetesia.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Siguroni informacionin nëse ato janë të organizuar.

Takimet me organizatat e shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë, INSTAT, bashkitë, Këshillin Kombëtar të Fëmijëve, ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë janë zhvilluar në data 16.01.2025; 01.07.2025; 31.10.2025; 13.11.2025 dhe 19.11.2025.

Sfondi i propozimit legjislativ

Përshkruani pse ka nevojë për rregulloren e re/të ndryshuar, d.m.th cila është gjendja aktuale, si është e rregulluar, cilat janë sfidat, problemet dhe mangësitë ekzistuese si të praktikës, ashtu edhe të rregulloreve ekzistuese, çfarë është bërë në të kaluarën ashtu siç duhet me keto politika.

Plani Kombëtar i Veprimit të Garancisë Evropiane për Fëmijët 2026–2030 është një iniciativë e re strategjike dhe gjithëpërfshirëse në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky plan reflekton angazhimin e vendit për të avancuar standardet evropiane të mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale të fëmijëve, duke vënë në qendër interesin më të lartë të tyre. Plani i përgjigjet në mënyrë të koordinuar nevojave të fëmijëve më të cenueshëm, përmes një qasjeje të integruar ndërsektoriale që forcon bashkëpunimin mes pushtetit vendor, institucioneve përgjegjëse në nivel qendror, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve strategjikë kombëtarë e ndërkombëtarë.

Analiza aktuale: Varfëria e fëmijëve në Shqipëri mbetet një fenomen i përhapur dhe shumëdimensional, me rreth 26,6% të fëmijëve (0–17 vjeç) në rrezik varfërie sipas EU-SILC 2024. Ekzistojnë dallime të lehta gjinore (26,8% vajza dhe 26,4% djem), si dhe pabarazi të theksuara rajonale. Varfëria lidhet ngushtë me situatën e punësimit në familje: 21% e fëmijëve në rrezik jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët punësimi, ndërsa rreziku i varfërisë arrin në 54,1% për familjet me intensitet të ulët dhe 88% për ato me intensitet shumë të ulët. Nivelet e privimit janë të larta, me 37% të fëmijëve që përjetojnë privim të thellë material dhe social, ndërsa kjo shifër arrin në 64% për familjet me tre ose më shumë fëmijë.

Programi i Ndhmës Ekonomike mbulon 61,932 fëmijë (48,9% vajza), që përfaqëson rreth gjysmën e fëmijëve të varfër. Nga këta, 7,1% janë fëmijë romë dhe egjiptianë, 3,8% fëmijë me aftësi të kufizuara, ndërsa një pjesë janë në kujdes alternativ ose me status jetimi. Në nivel familjar, 61% e përfituesve janë familje me fëmijë, me një madhësi mesatare prej 5 anëtarësh, dhe 13% e tyre janë të kryesuara nga gra.

Fëmijët në nevojë përfaqësojnë kategori të ndërthurura vulnerabiliteti. Komunitetet rome dhe egjiptiane, megjithëse përbëjnë më pak se 1% të popullsisë, përfaqësojnë 7,1% të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe 28,5% të fëmijëve në kujdes rezidencial. Rreth 11,000 fëmijë me aftësi të kufizuara janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, ndërsa 4,000 prej tyre kanë nevojë për shërbime të specializuara. Numri i fëmijëve në kujdes rezidencial ka rënë në 421 në vitin 2025, duke reflektuar progres në deinstitutionalizim.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve menaxhoi 2,451 raste në vitin 2024, nga të cilat 1,386 ishin raste të reja. Vetëm 28% e fëmijëve në nevojë për mbrojtje marrin shërbime, me diferenca të mëdha territoriale (56% në Tiranë kundrejt 1–3% në disa qarqe). Grupet më të prekura përfshijnë fëmijët me probleme ekonomike (30% e rasteve), viktimat e dhunës psikologjike (15%) dhe fëmijët në konflikt me ligjin (12%).

Në edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, vetëm 51,2% e fëmijëve 0–6 vjeç frekuentojnë institucione parashkollore (36,8% për moshën 0–3 dhe 52,1% për 3–6 vjeç). Pjesëmarrja është më e ulët për fëmijët romë dhe egjiptianë (38,3%) dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara (50,5%). Vetëm rreth 10% e fëmijëve nën 3 vjeç janë të regjistruar në çerdhe publike, ndërsa pjesa më e madhe e kujdesit ofrohet në mënyrë joformale.

Në arsim, vetëm 62% e nxënësve arrijnë nivel minimal në matematikë në fund të arsimit fillor, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët vetëm 48% në lexim dhe 58% në matematikë. Shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është 85%, me dallime për grupet vulnerabël. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor ka arritur në 3,835, ndërsa mësuesit ndihmës janë rritur në 2,469 në vitin 2024–2025.

Në shëndetësi, shërbimet për fëmijët ofrohen falas, por pagesat nga xhepi përbëjnë rreth 45% të shpenzimeve totale, duke ndikuar në akses. Rreth 66% e fëmijëve nga familje me të ardhura të ulëta, 46% në zonat rurale dhe 50% e fëmijëve romë dhe egjiptianë përballen me barriera në aksesin në shërbime. Programet parandaluese tregojnë rezultate pozitive, si vaksinimi dhe vizitat në shtëpi (13,802 vizita në 2024).

Në fushën e ushqyerjes, familjet shqiptare shpenzojnë mesatarisht 39,6% të buxhetit për ushqim. Treguesit ushqimorë tregojnë se 30% e fëmijëve 8–9 vjeç janë mbipeshë dhe 14% obezë, ndërsa më pak se gjysma e fëmijëve konsumojnë fruta dhe perime çdo ditë.

Në tërësi, situata aktuale reflekton një nivel të konsiderueshëm varfërie dhe pabarazish, të shoqëruara me dallime territoriale dhe sociale në aksesin ndaj shërbimeve. Megjithëse ekziston një kuadër i gjerë politikash dhe programesh, treguesit evidencojnë nevojën për përmirësim të mëtejshëm të mbulimit dhe përfshirjes së fëmijëve në shërbime thelbësore.

Sfidat:

Sistemi i kujdesit për fëmijët e vegjël përballlet me qeverisje të fragmentuar, pjesëmarrje të ulët dhe nënfinancim, larg standardeve të BE-së. Ekzistojnë pabarazi territoriale, kosto të larta për familjet dhe mungesë infrastrukture e personeli të kualifikuar, sidomos në zonat rurale. Gjithashtu, grupet

vulnerabël përballen me barriera dhe mungon një sistem i qëndrueshëm monitorimi dhe ndërhyrjeje të hershme.

Pabarazitë në akses dhe cilësi të arsimit prekin më shumë fëmijët nga grupet vulnerabël dhe zonat rurale, të ndikuara edhe nga barriera financiare. Sistemi përballlet me mbingarkesë në zonat urbane dhe infrastrukturë të dobët në disa zona. Ndërkohë, nismat pozitive mbeten të kufizuara dhe financimi i pamjaftueshëm për të adresuar në mënyrë të qëndrueshme këto sfida.

Akresi në shërbime shëndetësore kufizohet nga pagesat e larta nga xhepi dhe pabarazitë gjeografike e sociale, veçanërisht për grupet vulnerabël dhe zonat rurale. Sistemi përballlet me mungesë personeli të trajnuar, shërbime jo të përshtatshme për adoleshentët dhe programe të pamjaftueshme parandalimi. Gjithashtu, financimi i ulët dhe infrastruktura e dobët e përkeqësojnë situatën.

Akresi në ushqim të shëndetshëm kufizohet nga varfëria, mungesa e diversitetit ushqimor dhe edukimi i ulët për ushqyerjen, duke rritur rrezikun e kequshqyerjes tek fëmijët. Situata përkeqësohet nga mungesa e vakteve të shëndetshme në shkolla dhe konsum i lartë i produkteve jo të shëndetshme. Ndërkohë, programet publike mbeten të fragmentuara dhe të nënfinancuara.

Programet e strehimit social përballen me mungesë fokusimi tek fëmijët dhe familjet vulnerabël, si dhe me barriera si mungesa e dokumentacionit dhe mbipopullimi i banesave. Zbatimi pengohet nga kapacitetet e dobëta vendore, përdorimi i ulët i fondeve dhe koordinimi i kufizuar. Gjithashtu, kostot shtesë dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse rrezikojnë qëndrueshmërinë e përfituesve.

Në të kaluarën, politikat dhe ndërhyrjet në mbështetje të fëmijëve dhe familjeve kanë qenë të pranishme në kuadrin ligjor dhe në politikat sektoriale, duke reflektuar një angazhim institucional për adresimin e varfërisë dhe përjashtimit social. Megjithatë, këto ndërhyrje kanë qenë kryesisht të zhvilluara në mënyrë të fragmentuar, të shpërndara ndërmjet sektorëve si mbrojtja sociale, arsimit, shëndetësia dhe strehimi, pa një qasje të integruar dhe të koordinuar plotësisht. Si rrjedhojë, mungesa e ndërveprimit efektiv ndërmjet politikave dhe mekanizmave zbatues ka ndikuar në mbulimin jo të plotë të nevojave të fëmijëve dhe familjeve në situata vulnerabël, si dhe në efikasitetin e përgjithshëm të ndërhyrjeve.

Propozimet

Renditni dhe përshkruani në mënyrë të shkurtër dhe koncize të gjitha propozimet dhe ndryshimet që doni të prezantoni me rregulloren e reja. Përdorni një gjuhë të thjeshtë.

Plani Kombëtar i Veprimit i Garancisë Evropiane për Fëmijët 2026-2030 synon të përmirësojë situatën e fëmijëve në rrezik në Shqipëri duke u bazuar në strategjitë sektorale për periudhën 2026–2030 dhe duke promovuar bashkëpunimin ndërsektorial midis shëndetësisë, arsimit, strehimit, migracionit dhe mbrojtjes sociale. Plani vendos si prioritet trajtimin e varfërisë dhe rritjen e mirëqenies së fëmijëve, duke ndërthurur objektiva që fuqizojnë njëri-tjetrin dhe adresojnë nevojat specifike të grupmoshave më vulnerabël.

Në fushën e mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve, Plani përqendrohet në krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të përfitimeve për fëmijë që siguron një standard minimal jetese për të gjithë, duke reduktuar varfërinë dhe duke garantuar qasje të barabartë në mbështetje ekonomike. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, Plani synon të ofrojë mbështetje financiare dhe shërbime komunitare të integruara, duke përfshirë ndihmës personale të trajnuar, pajisje teknologjike ndihmëse në qendrat komunitare dhe mekanizma funksionalë të vlerësimit dhe referimit. Për fëmijët vulnerabël në nevojë për mbrojtje, Plani thekson rëndësinë e shërbimeve sociale të integruara, të cilat funksionojnë përmes ekipeve të profesionalizuara dhe bashkëpunimit ndërsektorial, si dhe të planeve individuale për mbrojtje dhe trajtim të rasteve specifike. Po ashtu, fokusi është te zhvillimi

i qendrave të integruara për fëmijë dhe familje, ofrimi i programeve për prindërim pozitiv, ndërhyrja e hershme për fëmijët që kanë përjetuar traumë ose dhunë, dhe mbështetja e fëmijëve migratorë, të pashoqëruar apo të vendosur në institucione rezidenciale. Plani gjithashtu parashikon zgjerimin e shërbimeve komunitare, ekipeve lëvizëse dhe ndihmësve personalë për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke synuar integrimin e plotë në jetën komunitare dhe barazinë në aksesin në shërbime.

Në fushën e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme, Plani fokusohet në zbatimin e masave që rrisin aksesin gjithëpërfshirës dhe cilësinë e shërbimeve për fëmijët 0–6 vjeç, me vëmendje të veçantë për ata nga familjet me të ardhura të ulëta dhe zonat e largëta. Përfshihen ndërhyrje për rritjen e regjistrimit në çerdhe dhe kopshte, fushata informimi për familjet dhe përmirësim i kuadrit qeverisës të EKFFH. Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe kujdesit synohet përmes standardeve kombëtare të harmonizuara, zhvillimit të kurrikulave të unifikuara për grupmoshat 0–3 dhe 3–6 vjeç, dhe fuqizimit të kapaciteteve të personelit përmes programeve të zhvillimit profesional të vazhdueshëm.

Në arsimin formal, Plani përqendrohet në eliminimin e pengesave financiare dhe jo-financiare për pjesëmarrjen në shkollë dhe garantimin e aksesit të barabartë për të gjithë fëmijët. Kjo përfshin sigurimin e materialeve shkollore falas për fëmijët vulnerabël, zhvillimin e një skeme mbështetëse për parandalimin e braktisjes shkollore dhe fuqizimin e shkollave për të krijuar mjedise gjithëpërfshirëse dhe të barabarta. Plani synon gjithashtu zhvillimin e moduleve digjitale dhe metodave hibride të mësimdhënies, për të mbështetur nxënësit në zonat me pak shërbime dhe komunitetet minoritare, si dhe programet jashtëshkollore që zhvillojnë aftësitë e shekullit 21 dhe përfshijnë fëmijët nga grupet në nevojë.

Në shëndetësi, Plani fokusohet në garantimin e aksesit të barabartë në shërbime bazë dhe të integruara, me theks në fëmijët në rrezik, duke përfshirë shëndetin mendor, ushqyerjen, dëgjimin dhe shëndetin oral. Zgjerimi i vizitave në shtëpi, zhvillimi i sistemeve digjitale për ndjekjen e shëndetit të fëmijëve dhe integrimi i protokolleve për shëndetin mendor në nivel komunitar synojnë identifikim të hershëm, mbështetje të vazhdueshme dhe qasje gjithëpërfshirëse.

Në fushën e ushqyerjes së shëndetshme, Plani synon të sigurojë akses universal për fëmijët në nevojë për ushqim të shëndetshëm, duke krijuar programe me bazë komunitare dhe politika kombëtare për vakte të shëndetshme në shkolla. Përfshihen ndërhyrje të fokusuar te komunitetet me të ardhura të ulëta, komunitetet romë dhe egjiptiane, si dhe programe për fortifikimin e ushqimit sipas rekomandimeve të OBSH-së. Një pjesë e rëndësishme e Plani është edukimi për ushqyerjen dhe integrimi i saj në kurrikula dhe aktivitete jashtëshkollore.

Në fushën e strehimit, Plani përqendrohet në transformimin e politikave dhe sistemeve drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse, të orientuar nga fëmijët dhe bazuar në barazi. Kjo përfshin zhvillimin e treguesve të strehimit për fëmijët, shpërndarjen e drejtë të fondeve dhe zgjerimin e aksesit në strehim tranzitor, emergjent dhe afatgjatë. Masat synojnë përmirësimin e skemave të subvencionimit, rehabilitimin e banesave të papërshtatshme dhe ofrimin e strehimit të përshtatshëm për familjet me fëmijë në rrezik të përjashtimit social. Për fëmijët me nevoja të veçanta, strehimi parashikon trajtime specifike për mbështetje adekuate dhe qëndrueshmëri.

Në këtë mënyrë, Plani Kombëtar i Veprimit strukturohet në mënyrë narrative dhe ndërsektoriale për të siguruar që fëmijët në Shqipëri, pavarësisht sfidave socio-ekonomike, të kenë akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në shërbime mbrojtjeje, arsimore, shëndetësore, ushqimore dhe strehimi, duke promovuar mirëqenie, zhvillim dhe barazi afatgjatë.

Pyetjet

Listoni pyetje për të cilat po kërkon reagime. Ato mund të lidhen me propozimet tuaja (p.sh. A jeni dakord me propozimin për ..., A jeni dakord që duhet të ndërmerren veprime të mëtejshme për të parandaluar/rritur ..., A jeni dakord që ne e quajmë shkelje ..., A pajtoheni me përkufizimin tonë të ri për ..., etj.) ose thjesht përdoren për të mbledhur të dhëna shtesë që ju kërkon (p.sh. Cili do të ishte ndikimi i propozimeve tona në biznesin tuaj, organizatat, A e bën organizata juaj ..., etj.). Ju mund të merrni parasysht kufizimin e gjatësisë së përgjigjeve për pyetjet individuale (p.sh. 250/500 fjalë).

1. A jeni dakord me propozimet për sistem gjithëpërfshirës të përfitimeve për fëmijët dhe për sigurimin e standardit minimal jetësor?
2. A pajtoheni me përmirësimin e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ndihmësit personalë, pajisjet ndihmëse dhe qendrat komunitare?
3. A jeni dakord që hartimi dhe monitorimi i planeve individuale për fëmijët vulnerabël të jetë pjesë kyçe e sistemit?
4. A pajtoheni me zgjerimin e shërbimeve komunitare dhe ekipeve lëvizëse për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara?
5. A mendoni se masat për edukimin dhe kujdesin e fëmijëve 0–6 vjeç janë të mjaftueshme?
6. A pajtoheni që programet për parandalimin e braktisjes shkollore të jenë të integruara me shërbimet sociale dhe mbështetjen ekonomike për familjet?
7. A mendoni se masat për shëndetin mendor dhe shëndetin bazë të fëmijëve janë të efektshme?
8. A pajtoheni me propozimet për sigurimin e ushqimit të shëndetshëm për fëmijët në nevojë dhe edukimin ushqimor?
9. A pajtoheni që politika e strehimit për familjet me fëmijë në rrezik të përfshijë strehim tranzitor, emergjent dhe afatgjatë?
10. Cili do të ishte ndikimi i përgjithshëm i këtyre propozimeve në organizatën ose komunitetin tuaj?